



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	07
Nr. i faqevave Broj stranica No. pages	1
Nr. Prot. Br. Prof. Prof.No:	522
Data: Datum: Date:	31-03-2026
PRISHTINE/A	NO.1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet B. Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor MAPL
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve/MAPL
Përmes:	Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë <i>p.p. Rizvanolli</i> Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
Nga:	Deniza Krasniqi, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor/MB <i>Deniza Krasniqi</i> Datë: 17.03.2026
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Dëfrim Pllashniku, Udhëheqës i Divizionit për Politika të NP/NJPMNP <i>D.Pllashniku</i> Arbërore Bërnica-Hasani, Analiste ligjore/NJPMNP <i>Arbërore Bërnica-Hasani</i>
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Suharekës
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr.410-9873 i Kuvendit të Komunës së Suharekës

I nderuar Kryetar z.Muharremaj,

I nderuar Kryesues z. Kuçi,

Ministria e Ekonomisë ka pranuar kërkesën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr. Prot. 321 datë 02.03.2026, për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal të Komunës së Suharekës, Vendimi 01 Nr.410-9873 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ekoregjioni" Sh.A., të miratuar më datë 26.02.2026 nga Kuvendi Komunal i Suharekës.

Bazuar në nenin 9, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, dhe legjislacionin përkatës në fuqi për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, vlerëson

se Vendimi 01 Nr.410-9873 për Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ekoregioni" Sh.A., nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Arsyetim

Neni 3 i aktit të shqyrtuar parasheh që anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve të kompensohen nga mjetet vetanake të ndërmarrjes. Kjo bie ndesh me ligjin, sepse aksionari nuk mund t'i shfrytëzojë asetet e ndërmarrjes për qëllime të veta; ai duhet ta paguajë përfaqësuesin me mjetet e veta.

Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (LNP), i ndryshuar me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-111, parasheh që ndërmarrja kompenzon anëtarët e bordit, por nuk ofron kompensim për përfaqësuesit e aksionarit. Sipas parimit *_inclusio unius est exclusio alterius_* (përfshija e njërit është përjashtimi i tjetrit), i bie që ndërmarrja nuk mund ta kompensojë përfaqësuesin e aksionarit. Gjithsesi, përfaqësuesi vepron për aksionarin, jo për ndërmarrjen.

Sipas nenit 1.2 të LNP-së, ligji për shoqëritë tregtare vlen për çështjet që nuk mbulohen nga LNP. Neni 118 i Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare përcakton: "Shoqëria Aksionare është person juridik në pronësi të Aksionarëve të saj por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët. Aksionari i një Shoqërie Aksionare nuk është bashkë-pronar dhe nuk ka interes të transferueshëm në pronën ose asetet e Shoqërisë Aksionare." Rrjedhimisht, aksionari nuk mund ta përdorë pasurinë e ndërmarrjes për të kompensuar përfaqësuesit e vet

Në këtë kontekst, bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, Komuna e Prizrenit duhet të rishqyrtojë dhe harmonizojë këtë vendim me dispozitat ligjore në fuqi brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij vlerësimi.

Ministria e Ekonomisë mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,

*** Vlerësimi i dhënë nga Ministria e Ekonomisë përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin e Ministrisë së Ekonomisë si sponsorizuese e legjislacionit për Ndërmarrjet Publike***